

VENDIM
Nr. 121, datë 28.2.2018

PËR LEJIMIN E LËVIZJES JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË 11 VEPRAVE TË PIKTORIT TË POPULLIT VANGJUSH MIO, ME QËLLIM EKSPOZIMIN E TYRE NË CENTRO CULTURALE DON ORIONE ARTIGIANELLI, SALA TIZIANO, DORSODURO 909/A – VENECIA, ITALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 11 veprave të Piktorit të Popullit Vangjush Mio, me qëllim ekspozimin e tyre në Centro Culturale Don Orione Artigianelli, Sala Tiziano, Dorsoduro 909/a në Venecia, Itali, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lëvizja e veprave të artit të bëhet për periudhën 1 mars 2018 – 30 prill 2018.

3. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e lëvizjes së objekteve të trashëgimisë kulturore, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

4. Ngarkohet znj. Migena Hajdari, përfaqësuese me prokurë të posaçme me nr. 689 rep., nr. 571 kol., të kryejë shoqërimin dhe kthimin e veprave në vendin e origjinës, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë vendim.

5. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë procedurën e monitorimit dhe regjistrimit të lëvizjes së veprave.

6. Ngarkohet ministri i Kulturës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

LISTA E OBJEKTEVE – TRASHËGIMI ME VLERA TË VEÇANTA

NR. rend.	KODI QKIPK	NR. INV.	AUTORI KODI I AUTORIT	POSEDUES KODI I POSEDUESIT	TTULLI I VEPRËS
1	17763	7	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	NË STUDION E PIKTORIT
2	153944	82	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	NUDO
3	17764	23	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	PORTRET PLAKU (STUDIM) ROM
4	17765	24	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	PORTRETI I GRUAS SË PIKTORIT
5	17796	44	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	NUDO GRUAJE NË KËMBË
6	17797	45	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	NUDO GRUAJE ULUR
7	17778	32	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	TË KORRURAT
8	153941	79	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	NUDO
9	153945	83	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	PORTRET
10.	17793	17	Vangjush Mio	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	PORTRET “GAJDEXHIU” ROM

LISTA E OBJEKTEVE – TRASHËGIMI ME VLERA TË VEÇANTA

NR. rend.	KODI QKIPK	NR. INV.	AUTORI KODI I AUTORIT	POSEDUES KODI I POSEDUESIT	TTULLI I VEPRËS
1	17758	20	Vangjush Mio (005)	Koleksioni privat “Vangjush Mio”	AUTOPORTRET